



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Petrol Company shpk" të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Petrol Company shpk" të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Petrol Company shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 05.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Kriteri për dhënien e kontratës ka qenë **“Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”**, me nën-kriteret:

Çmimi – **60%**

Garancioni i punimeve – **20%**

Plani dinamik i realizimit – **20%**

Grupi ynë i OE ka dorëzuar:

ofertë me **çmim total të plotë, të fiksuar dhe të krahasueshëm;**

ofertë **ekonomikisht më të favorshme** se ajo e rekomanduar;

dokumentacion të plotë për të gjitha kriteret e dhënies së kontratës.

Eliminimi është bërë **vetëm për shkak të dy pozicioneve në paramasë (BOQ) të paraqitura me vlerë 0 €, pa analizë materiale dhe pa kërkesë për sqarim.**

Paramasa nuk është kriter eliminues

Paramasa:

nuk është kriter për dhënien e kontratës;

nuk ka peshë pikëzimi;

nuk është përcaktuar si kusht eliminues në Dosjen e Tenderit.

Përdorimi i saj si bazë për eliminim përbën **vendosje të kriterëve të fshehta**, në kundërshtim me ligjin.

Dy pozicionet me vlerë 0 € janë të përfshira në çmimin total

Punimet për dy pozicionet e paramasës:

janë të **përfshira realisht në çmimin total të ofertës;**

nuk e ndryshojnë çmimin dhe nuk krijojnë asnjë avantazh të padrejtë;

çmimi total është **i detyrueshëm dhe i pandryshueshëm** për OE.

Prandaj, oferta jonë është ofertë e përgjegjshme dhe plotësisht e krahasueshme.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Nuk i keni përmbushur kriteret sipas dosjes së tenderit

ARSYETIM:

Grup i Operatorëve Ekonomik Petrol Company - SH.P.K.; Bek Fluids L.L.C.; LIMITPROJECT SH.P.K.; H & B - Consulting SH.P.K.; R & Rukolli, ne oferten e tyre kane ofruar paramasen me çmimin perfundimtar te ofertes, mirepo, ne dy pozicione nuk kane dhënë çmimin fare , pra rubrikat jane te zbrazeta, si ne vijim:

1.Ne kapitullin e pare te paramases „**ARKITEKTURA**”, pozicioni 11.8. Furnizimi dhe montimi i deres se garazhit: copë - 1 , nuk ka vendosur fare çmim.

11.8	Furnizimi dhe montimi i deres se garazhit	Supply and install garage door	copë/pcs	1		0.00
------	---	--------------------------------	----------	---	--	------

Gjithashtu ne kapitullin „**INSTALIMET ELEKTRIKE**”, pozicioni 8.5. Kablo STFP 4x2xAWG24, CAT per camera : m'-3500, nuk ka vendosur fare çmim.

8.5	Kablo STFP 4x2xAWG24, CAT per Kamera	Cable STFP 4x2xAWG24, Cat 7 for Camera	m'	3,500		0.00
-----	--------------------------------------	--	----	-------	--	------

Andaj, duke u bazuar ne Udhzues Nr.001/2023 PER PROKURIM PUBLIK, vendosja e çmimit , eshte kusht administrativ.

Pra, decidivisht thotë:

Kur mungon çmimi - REFUZO tenderin pa kerkuar informacion te metejshe - KUSHT ADMINISTRATIV. Siç shihet ne vijim:

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Faqe 40

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Andaj, Grup i Operatorëve Ekonomik Petrol Company - SH.P.K.; Bek Fluids L.L.C.; LIMITPROJECT SH.P.K.; H & B - Consulting SH.P.K.; R & Rukolli, eshte I papergjegjshem dhe eliminohet.

Tenderi i juaj Kërkesa e juaj për pjesëmarrje është administrativisht e papërgjegjshme.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Më konkretisht, është gjetur se parashtruesi në paramasën e tij për dy (2) pozicione (arkitektura 11.8 dhe instalimet elektrike 8.5) nuk ka ofertuar fare as çmim për njësi dhe as çmim për pozicionin. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Megjithatë parashtruesi argumenton pretendimin e tij me faktin që kriter për dhënien e kontratës ka qenë çmimi dhe jo paramasa. Ky argument është i paqëndrueshëm dhe i palogjikshëm për faktin që çmimi përcaktohen pikërisht përmes paramasës. Pra paramasa dhe çmimi janë të ndërlidhura ngushtë mes tyre, pa çka se plotësimi i paramasës përtej kriterit të dhënies, është kërkesë e dosjes së tenderit por edhe kusht administrativ. Kjo për arsye se përmes pikës 10.1 të UPP përcaktohet se plotësimi i cmimeve në paramasë është kusht administrativ për të cilin fare nuk kërkohen as sqarime shtesë por automatikisht eliminohet oferta e tenderuesit si e papërgjegjshme. Nga ky këndvështrim, nuk qëndron as argumenti tjetër i parashtruesit sipas të cilit AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë sepse për situatën e tillë UPP përcakton se nuk duhet të kërkohen sqarime shtesë. Argumenti tjetër i cili është paradoksal dhe kundërthënës me pretendimin ankimor, sipas parashtruesit është se pozicionet në paramasë do të trajtohen si pozicione me çmime zero euro. Natyrisht që kjo do të ishte e kundërligjshme pasi që në pozicion nuk ka fare çmim për njësi. Çmimi zero edhe po të ishte i ligjshëm, do të ishte abnormalisht i ulët dhe si i tillë sërish do të ishte i papranueshëm. Pra nëse një OE dëshiron të realizoj punë pa pagesë për AK, atëherë kjo çështje rregullohet sipas një ligji tjetër për donacionet dhe jo sipas legjislacionit për prokurimin publik. Pra absolutisht nga të gjitha këndvështrimet e mundshme ligjore dhe praktike, pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Në fund por jo për nga rëndësia, përtej faktit që pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara, edhe parashtruesi si i tillë nuk është fare palë e interesuar për këtë aktivitet të prokurimit në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP ku definicioni i termit “palë e interesuar” përcaktohet si vijon *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*.

Në rastin konkret parashtruesi nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit pasi që anëtarë i GOE “Limit Project” me datë 07.01.2025 ka dërguar te AK një email ku thuhet se i njëjti pajtohet me vendimin B58 të AK dhe arsyet për eliminimin e GOE janë kushte administrative të papërmisueshme. Njëkohësisht ka shtuar se të gjitha kërkesat për rishqyrtim ndaj këtij vendimi të AK nuk e kanë miratimin e tyre si anëtarë të GOE dhe ata nuk janë pjesë e këtyre kërkesave. Teksti i plotë i njoftimit të OE “Limit Project shpk” që është anëtarë i GOE ku lider është parashtruesi, është si në vijim:

From: Limit Project <limitproject.shpk@gmail.com>
Sent: Wednesday, January 7, 2026 12:37:19 PM
To: Prokurimi Prishtine; Visar Shehu
Subject: Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore

Te nderuar,

Duke u bazuar ne vendimin e dhene nga ana juaj si autoritet kontraktues, lidhur me vleresimin e dosjes se tenderit: Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore, si anetare te konzorciumit, ju njoftojme se pajtohemi me vleresimin e dosjes se tenderit dhe meqe gabimet jane qe nuk rikuperohen me sqarimet dhe jane administrativisht te pakalueshme, nuk do te paraqesim kerkese per rishqyrtim dhe nuk jemi pjese e kerkesave per rishqyrtim si dhe kerkesat nese vijne per rishqyrtim, nuk kane aprovimin tone si anetare te konzorciumit.

Ju faleminderit paraprakisht!

me respekt:

"LIMIT PROJECT" SH.P.K.

tel: +38345 401 976

+383 44 90 55 55

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.01.2026



Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 5 nga 5

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net